



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

VENDIM

Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.24 datë 02.06.2016 “Për krijimin e Shoqërisë Aksionare të Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës, dhe miratimin e Statutit”
Nr. 51, datë 08/10/2016

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, në vijim të shkresës Nr.477/1.Prot, datë 20.06.2016 të Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkoder, dhe në mbështetje të Ligjit Nr.8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar, neni 14 pika 2 germa “b” ku ndër të tjera, citon: “Për çdo akt të rregjistruar në zyrën e protokollit, prefekti detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme: i) Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit i lind e drejta t’ia ktheje atë organit përkatës të qeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i qeverisjes vendore rishqyrton aktin. Vendimi i marrë nga organi i qeverisjes vendore pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga Prefekti, depozitohet pranë Prefektit me të njëjtën procedure dhe afat si në shkronjën “a” të kësaj pike”, **mori dhe një herë në shqyrtim Vendimin Nr.24 datë 02.06.2016 “Për krijimin e Shoqërisë Aksionare të Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës, dhe miratimin e Statutit të saj”**,

Baza Ligjore: Ligji Nr.139/2015 dat 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 2, pika 7 “Ndërmarrje për shërbime publike” është çdo ndërmarrje e krijuar për të ofruar shërbim/shërbime publik/e që janë kompetencë e bashkisë, për të cilën kapitali, vota ose e drejta për të emëruar organet drejtuese dhe financimi kontrollohen nga bashkia”; neni 22 pika 1 “Njësitë e vetqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi”; neni 23 pika 1, 2 “Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 1.Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm. 2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; neni 33 pika 1 germa “d” “krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi”; neni 53, neni 54 pika “d” “miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues”; neni 55 pika 3 “Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji”; neni 55 pika 6, “ Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në

En e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to”. Ligji Nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të ujësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 3 pika 1 “Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm)”; Pjesa V, neni 107 pika 1, neni 108, neni 113 pika 1, Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM Nr.63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pas njoftimit të Institucionit të Prefektit lidhur me gjendjen juridike të ujësjellësave në juridiksionin e Bashkisë Vau Dejës, me shkresën Nr.1475/1.Prot datë 26.09.2016¹, rishqyrtoi të gjithë dokumentacionin, dhe në mbledhjen e datës 08/10/2016,

VENDOSI:

1. Rishqyrtrimin e Vendimit Nr.24 datë 02.06.2016 “Për krijimin e Shoqërisë Aksionare të Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës, dhe miratimin e Statutit”, si më poshtë vijon:
 - a. **Objekti i vendimit:**
Ishte: “Për krijimin e Shoqërisë Aksionare të Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës, dhe miratimin e Statutit”
Bëhet: “Miratimin e aktit të themelimit të shoqërive tregtare Ujësjellës – Kanalizime Vau Dejës sha”. (bashkëlidhur vendimit)
 - b. **Pika 1 e vendimit Nr.24, datë 02.06.2016:**
Ishte: Krijimin e shoqërisë aksionare “Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës”, me kapital themeltar 10,000,000 (dhjetë milion) lekë, me pronar 100 % të aksioneve Bashkia Vau Dejës”.
Bëhet: Riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në juridiksionin e Bashkisë Vau Dejës, konkretisht: Ndërmarrjes ekzistuese Ujësjellës Vau Dejës, Sektorit të Ujësjellësit pranë NJA Bushat, Ujësjellësi Hajmel dhe Ujësjellësi Temal (pjesë e Ujësjellësit Fshat sh.a), NjA Shllak, NjA Vig Mnelë, në formën e shoqërisë aksionare me një nivel administrimi, me kapital fillestar 3,500,000 lekë (tre milion e pesëqind mijë).
 - c. **Pika 2 e vendimit nr.24, datë 02.06.2016:**
Statuti i shoqërisë aksionare “Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës” sha, ndryshohet sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ndërsa kontributet në natyrë do të përbëhen nga vlerësimi që do të bëjë një ekspert i caktuar nga gjykata kompetente, vlerësim i cili do të materializohet në një raport vlerësimi që përmban një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë të Ndërmarrjes ekzistuese Ujësjellës Vau Dejës, Sektorit të Ujësjellësit pranë NJA Bushat, Ujësjellësi Hajmel dhe Ujësjellësi Temal (pjesë e Ujësjellësit Fshat sh.a), NjA Shllak, NjA Vig Mnelë, të cilat do të shtohen më pas në kapitalin e shoqërisë aksionare, sipas procedurave ligjore në fuqi.
3. Afati për realizimin e pikës 2 të këtij vendimi është data 31 dhjetor 2016.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë.



5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

6. U shpall sot me date 10/10 2016.

SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU